REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni Hetimor "Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore."

VENDIM I NDËRMJETËM

Nr. 8, datë 18.09.2019

"PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR"

Komisioni hetimor "Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", në mbledhjen e tij të datës 18.09.2019, bazuar në nenin 13, pika 2, në nenin 14, shkronja "ç", të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe nenit 7, pika 1, nenit 25 të Rregullores së Kuvendit,

VENDOSI:

I. T'i drejtohet Kryetarit të Kuvendit, Z.Gramoz Ruçi me një kërkesë për zgjatjen me 2 muaj të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit "Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ulsi MANJA

3. Diskutime për çështje të tjera

Sikurse jeni në dijeni, në datën 10.09.2019 komisioni i është drejtuar Presidentit të Republikës, shkëlqesisë së tij zotit Ilir META, me një kërkesë për vënie në dispozicion të informacionit që Presidenti citoi në seancë dëgjimore, informacion i marrë në datën 07.06.2019 nga institucionet më të larta të sigurisë kombëtare, si edhe nga burime të tjera të besueshme zyrtare.

Presidenti i Republikës i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së komisionit, duke dërguar informacionin e kërkuar, i cili do të administrohet nga komisioni së bashku me gjithë dokumentacionin e ardhur nga institucionet e tjera lidhur me objektin e hetimit.

Ju informoj se, bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të drejtën e njohjes së informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", e kanë vetëm personat e pajisur me certifikatë sigurie nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Nga informacioni i marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit me shkresën nr. 3284 prot, datë 17.09.2019, rezulton se jo të gjithë anëtarët e komisionit hetimor janë të pajisur me certifikatë sigurie.

Rezulton se janë pajisur me certifikatë:
Anëtarët e komisionit:
z. Ulsi Manja
znj. Klotilda Bushka,
znj. Vasilika Hysi

Anëtarët zëvendësues:
z. Adnor Shameti
z. Spartak Braho
z. Arlind Çacani

Stafi teknik
Znj. Mimoza Arbi